



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.71

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9560 datë 12.6.2006	Për ratifikimin e amendamentit të dispozitave, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë..... 2035
Dekret nr.4945 datë 27.6.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 2057
Dekret nr.4948 datë 29.6.2006	Për lirim ambasadori..... 2058
Dekret nr.4949 datë 29.6.2006	Për lirim ambasadori..... 2059
Dekret nr.4950 datë 29.6.2006	Për lirim ambasadori..... 2059

L I G J
Nr. 9560, datë 12.6.2006

**PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT TË DISPOZITAVE, QË LIDHEN ME
TREGTINË, TË TRAKTATIT TË KARTËS SË ENER GjISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet amendamenti i dispozitave, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë, që janë pjesë përbërëse të aktit final të Konferencës Ndërkombëtare dhe vendimit të Konferencës së Kartës së Energjisë, të mbajtur në Bruksel në datat 23-24 prill 1998.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4943, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

AMENDAMENT

**NË LIDHJE ME DISPOZITAT QË LIDHEN ME TREGTINË NGA TRAKTATI I KARTËS SË
ENER GjISË**

Ky shënim skicon elementet e amendamentit të rëna dakord në Konferencën e Prillit 1998, elemente të cilat shtohen në tekstin e TKE.

1. Amendamenti konsiston në Aktin Final, i cili përmban tre kuptime dhe dy deklarata bashkëpunimi që lidhen me amendamentin; Aneksi 1 i Aktit Final është vetë amendamenti, i cili konsiston në shtatë nene; Aneksi 2 i Aktit Final përmban dy vendime.

2. Neni 1 i amendamentit (Aneksi 1 i Aktit Final) përmban tekstin e nenit 29 (Dispozita të Përkohshme për Çështjet që Lidhen me Tregtinë) i vendosur në Traktin e Kartës së Energjisë (TKE).

Neni 2 përmban të tjera amendamente të rëndësishme të TKE (përfshihen amendamentet për anekset D dhe G).

Neni 3 përmban amendamente të aneksit D të TKE (Mekanizmin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes Lidhur me Tregtinë)

Neni 4 përmban tekstin e aneksit W (Zbatimi i dispozitave të marrëveshjes së WTO) të vendosur në aneksin G të TKE.

Neni 5 përmban anekse të reja lidhur me tregtinë të futura në TKE (Anekset EM II, EQ I, EQ II, BR dhe BQR).

Neni 6 është zbatimi i dispozitave të përkohshme të amendamentit.

Neni 7 i bën vendimet një pjesë integrale të TKE.

3. Amendimi zgjeron regjimin e tregtisë për të mbuluar pajisjet që lidhen me energjinë. Ai vendoset në çështjet dhe referencat e vjetra të GATT 47 me referencat dhe çështjet aktuale të OBT.

Gjithashtu, koherenca në zbatimin e rregullave të OBТ në TKE dhe në OBТ sigurohet (shiko nenin 2, përcaktimet e reja të OBТ që amendohen në nenin 1 (11) dhe aneksin W, paragrafin (b) (10).

4. Teksti i nenit 29 siguron një veprim më të mirë të marrëveshjes tarifore për të dyja produktet dhe materialet e energjisë (Aneks EM 1) dhe pajisjet që lidhen me energjinë (Aneks EQ I) (shiko paragrafin 4 dhe 5).

Kjo plotësohet nga mundësia për të shkuar drejt një marrëveshjeje ligjore detyruese në të ardhmen për të rënë dakord për çështjet të cilat janë subjekt aktual për veprime më të mira (shiko paragrafin 6 dhe 7).

Në këtë pikëpamje, është dispozita që i jep shtytje çështjeve në nivel të një marrëveshjeje ligjore detyruese tarifore për një datë të mëvonshme nga një vendim i konferencës që kërkon votë unanime. Kjo procedurë reflektohet në nenin 2 përmes amendamentit të TKE të nenit 34(3) (paragrafi i ri (0) dhe neni 36(1) (paragrafi i ri (g)).

5. Aneksi aktual EM i TKE për produktet dhe materialet e energjisë bëhet aneksi EM I (shiko nenin 2 të riquajtur aneks EM). Pajisjet që lidhen me energjinë listohen në aneksin EQ I të ri (shiko nenin 5 të amendamentit). Pajisjet që lidhen me energjinë përcaktohen në të njëjtën mënyrë si produktet dhe materialet e energjisë (shiko nenin 2 të amendamentit ku futet një nen 1(4bis) i ri në TKE). Çështjet subjekt të një marrëveshjeje ligjore detyruese tarifore do të listohen në aneksin EM II dhe EQ II, të dyja të paplotësuara deri në vendimin e konferencës për të kundërtën. Vlerësimet vjetore nga konferenca për mundësinë e lëvizjes së çështjeve drejt një marrëveshjeje detyruese ligjore sigurohen në kuptimin nr.3.

6. Konferenca e Kartës, në vendimin për lëvizjen e çështjeve drejt marrëveshjeve ligjore të palëvizshme, do të vendosë gjithashtu listën e vendeve në aneksin BR/BQR. Kjo sigurohet në paragrafin (7) të nenit 29 dhe të nenit 2 të amendamentit duke përfshirë një nënparagraf të ri (n) në TKE neni 34(3). Kuptimi nr. 2 ka të bëjë me marrëveshjet e vendeve joanëtare të OBТ të listuara në anekset BR dhe BQR. Vendimi nr. 2 siguron një procedurë të përcaktuar për vendet të cilat nuk janë duke e mbështetur amendamentin dhe të cilat nuk janë listuar në këto anekse kur konferenca merr një vendim për lëvizjen e çështjeve drejt një marrëveshjeje ligjore detyruese tarifore.

7. Vendimi nr. 2 siguron që dispozitat finale të amendamentit do të bazohen në pjesën VIII të TKE deri tani aktual. Kjo ka të bëjë në veçanti me hyrjen në fuqi të amendamentit (Neni 42 i TKE).

AKTI FINAL I KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE DHE VENDIMI I KONFERENCËS SË KARTËS SË ENERGIJË

I. Midis 17 dhjetorit 1994 dhe 18 dhjetorit 1997 Konferenca e Kartës së Energjisë i takoi të negociojë një amendament për dispozitat që lidhen me tregtinë të TKE. Një konferencë për të miratuar amendamentin është mbajtur në Bruksel më 23-24 prill 1998. Përfaqësuesit e "Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Australia, Republika e Austrisë, Republika e Azerbajxhanit, Mbretëria e Belgjikës, Republika e Bjellorusisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Qipros, Republika Çeke, Mbretëria e Danimarkës, Republika e Estonisë, Komunitetet Europiane, Republika e Finlandës, Republika Franceze, Republika e Gjeorgjisë, Republika Federale e Gjermanisë, Republika Greke, Republika e Hungarisë, Republika e Islandës, Irlanda, Republika Italiane, Japonia, Republika e Kazakistanit, Republika e Kirgizstanit, Republika e Letonisë, Principata e Lihtenshtajnit, Republika e Lituaniës, Dukati i Madh i Luksemburgut, Republika e Maltës, Republika e Moldoves, Mbretëria e Vendeve të Ulëta, Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Polonisë, Republika Portugeze, Rumania, Federata Ruse, Republika Sllovaqe, Republika e Sllovenisë, Mbretëria e Spanjës, Mbretëria e Suedisë, Konfederata Zvicerane, Republika e Taxhikistanit, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Turqisë, Turkmenistani, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Republika e Uzbekistanit" (këtu e më poshtë i referohemi si Përfaqësuesit") morën pjesë në konferencë, si dhe të ftuar që morën pjesë si vëzhgues nga vende të ndryshme dhe organizata ndërkombëtare.

II. Konferenca e Kartës së Energjisë, e cila vendosi përfundimisht të hyjë në fuqi në 16 prill 1998 TKE, gjithashtu vendosi që më 23-24 prill 1998 të marrë në konsideratë miratimin e amendamentit të dispozitave që lidhen me energjinë të TKE në përputhje me dispozitat e TKE.

AMENDAMENTI PËR DISPOZITAT QË LIDHEN ME TREGTINË NË TKE

III. Teksti i amendamentit të dispozitave që lidhen me tregtinë të TKE (këtu i referohuni si "Amendamenti"), i cili është shpallur në aneksin 1 dhe vendimet që lidhen këtu të cilat janë paraqitur në aneksin 2 miratuar në përputhje me modalitetet e konferencës ndërkombëtare justifikojnë këtë qëllim dhe TKE duke qenë në përputhje me procedurat që siguron Traktati.

KUPTIMET

IV. Kuptimet e mëposhtme në lidhje me amendamentin janë miratuar:

1. Kuptimi në lidhje me nenin 29(2) dhe aneksin W :

Pavarësisht listës së paragrafit 6 të nenit XXIV të GATT-it 1994 në aneksin W (A)(1)(a)(i), çdo nënshkrues që preket nga një ngritje e taksave doganore ose të tjera ndryshime të çdo lloji që detyrojnë ose në lidhje me importimin ose eksportimin referuar në fjalinë e parë të këtij paragrafi, lejohet të kërkojë konsultime në Konferencën e Kartës.

2. Kuptimi në lidhje me nenin 29(7):

Në rastin e një nënshkruesi, jo pjesëtar i OBT, i cili është listuar në anekset BR ose BRQ ose së bashku, çdo koncesion që ofrohet formalisht në procesin e pranimi të tij në OBT në lidhje me produktet dhe materialet e energjisë që listohen në aneksin EM II ose të pajisjeve që lidhen me energjinë që listohen në aneksin EQ II, për qëllimin e këtij neni, do të shikohet si një marrëveshje nën OBT.

3. Kuptimi në lidhje me nenin 29(6) dhe (7) si dhe 34(3)(o):

Konferenca e Kartës do të kryejë një paraqitje vjetore në lidhje me çdo mundësi të lëvizjes së çështjeve të produkteve dhe materialeve të energjisë ose pajisjeve që lidhen me energjinë nga anekset EM I ose EQ I në anekset EM II ose EQ II.

DEKLARATAT

V. Në vijim të deklaratave të bëra në lidhje me amendamentin:

Deklarata e bashkëpunimit për të drejtat e pronësisë intelektuale që lidhet me tregtinë.

Nënshkruesit konfirmojnë marrëveshjen e tyre për të siguruar mbrojtjen efektive të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale përfshijnë për qëllimin e kësaj deklarate në mënyrë të veçantë "copyright" dhe të drejtat që lidhen (duke përfshirë programet e kompjuterit dhe bazën e të dhënave), markën e fabrikës, treguesit gjeografikë, patentat, projektet, produktet gjysmë përçuese topografike dhe informacionet të pambyllura.

Deklarata e bashkëpunimit nga Federata Ruse dhe Bashkimi Europian

Federata Ruse ka ngritur çështjen e materialeve nukleare. Federata Ruse dhe BE ranë dakord që marrëveshja për partneritet dhe bashkëpunim midis Federatës Ruse, BE-së dhe shteteve pjesëmarrëse, e cila hyn në fuqi në 1 dhjetor 1997, është kuadër i përshtatshëm që ka të bëjë me këtë çështje, siç konfirmohet në konkluzionet e 27 janarit 1998 nga Këshilli i Bashkëpunimit.

AMENDAMENTI PËR DISPOZITAT QË LIDHEN ME TREGTINË NË TKE

(Aneksi 1 i Aktit Final i Konferencës Ndërkombëtare dhe vendimi i Konferencës së Kartës së Energjisë)

Neni 1

Neni 29 i traktatit do të rivendoset në tekst si më poshtë:

Dispozita të përkohshme për çështje lidhur me tregtinë

1) Dispozitat e këtij neni do të zbatohen për tregtinë me materiale dhe prodhime të energjisë dhe pajisje që lidhen me energjinë, pavarësisht se ndonjë Palë Kontraktuese nuk është pjesëmarrëse në OBT.

2)(a) Tregtia me materiale dhe prodhime të energjisë dhe pajisjeve që lidhen me energjinë ndërmjet Palëve Kontraktuese të paktën një prej të cilave nuk është pjesëmarrëse e OBT do të administrohet, duke iu nënshtruar nënparagrafit (b) dhe përjashtimeve nga rregullave të përmendura në aneksin W, nga dispozitat e marrëveshjes së OBT siç zbatohen dhe praktikohet lidhur me materialet dhe prodhimet e energjisë dhe pajisjeve që lidhen me energjinë nga pjesëmarrësit të OBT ndërmjet tyre, sikur të gjitha Palët Kontraktuese të ishin pjesëmarrëse në OBT.

b) Kjo tregti e një Pale Kontraktuese e cila është një shtet që ishte pjesë përbërëse e ish Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike mundet që, në vend të tyre, duke iu nënshtruar dispozitave të aneksit TFU, të administrohet nga një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve, deri më 1 dhjetor 1999 ose deri në pranimin e asaj Pale Kontraktuese në OBT, cilado qoftë më herët.

3.a) Çdo nënshkrues i këtij traktati dhe çdo shtet ose Organizatë e Integritit Ekonomik Rajonal që hyn me këtë traktat përpara 24 prillit 1998, në datën e nënshkrimit ose të depozitimit prej saj të instrumentit të aderimit, do t'i japë sekretariatit një listë të të gjitha taksave doganore dhe ngarkesave të çdo lloj detyrimi ose në lidhje me importin ose eksportin e materialeve dhe produkteve të energjisë, duke njoftuar për nivelin e këtyre taksave doganore dhe detyrimeve që zbatohen në ditën e nënshkrimit ose të depozitimit. Çdo nënshkrues i këtij traktati, dhe i çdo shteti ose organizate rajonale të integritit ekonomik që bie dakord për këtë traktat përpara 24 prillit 1998 do t'i sigurojë sekretariatit për këtë datë një listë të të gjitha taksave doganore dhe ngarkesave të çdo lloj detyrimi ose në lidhje me importin ose eksportin e pajisjeve që lidhen me energjinë, që përcaktojnë nivelin e çdo takse doganore dhe detyrimeve që kanë të bëjnë në këtë datë.

b) Çdo shteti ose organizate rajonale të integritit ekonomik që bie dakord për këtë traktat në ose pas 24 prillit 1998, në datën e nënshkrimit ose të depozitimit prej saj të instrumentit të aderimit, do t'i japë sekretariatit një listë të të gjitha taksave doganore dhe ngarkesave të çdo lloj detyrimi ose në lidhje me importin ose eksportin e materialeve dhe produkteve të energjisë dhe pajisjeve që lidhen me energjinë, që përcaktojnë nivelin e çdo takse doganore dhe detyrimeve që kanë të bëjnë në këtë datë të depozitimit.

Çdo ndryshim për taksat doganore dhe ngarkesave të çdo lloj detyrimi ose në lidhje me importin ose eksportin do t'i raportohet sekretariatit, i cili do të informojë Palët Kontraktuese për këto ndryshime.

4) Çdo Palë Kontraktuese do të përpiqet të mos rrisë asnjë taksë doganore ose ngarkesave të çdo lloj detyrimi ose në lidhje me importin ose eksportin:

a) në rastin e importit të materialeve dhe produkteve të energjisë të listuara në aneksin EM I ose të pajisjeve që lidhen me energjinë listuara në aneksin EQ I dhe përshkruara në pjesën I të Skedulës që lidhet me Palën Kontraktuese të referuara në nenin II të GATT-it 1994, mbi nivelin e përcaktuar në atë Skedule, në rast se Pala Kontraktuese është pjesëmarrëse në OBT;

b) në rastin e eksportimit të materialeve dhe prodhimeve të energjisë, të listuara në aneksin EM I ose të pajisjeve që lidhen me energjinë listuara në aneksin EQ I, dhe të importimit të tyre në rast se Pala Kontraktuese nuk është pjesëmarrëse e OBT, mbi nivelin e njoftuar më së fundi në sekretariat, përveç se siç lejohet nga dispozitat e bëra të zbatueshme nga nënparagrafi (2) (a).

5) Një Palë Kontraktuese mund të rrisë një masë të tillë taksën doganore ose detyrimi tjetër mbi nivelin e referuar në paragrafin (4) vetëm në qoftë se:

a) në rastin e një takse doganore ose të tjera ngarkesa detyruese që lidhen me importin, ku veprime të tilla nuk konfliktohen me dispozitat të aplikueshme të Marrëveshjes së OBT ose me të tjera dispozita të Marrëveshjes së OBT të listuara në aneksin W; ose

b) në masën më të plotë të praktikueshme sipas procedurave të saj legislative ajo ka njoftuar sekretariatit për propozimin e saj për një rritje të tillë, u ka dhënë Palëve Kontraktuese të tjera të interesuara mundësi të arsyeshme për konsultim lidhur me propozimin e saj, dhe ka marrë në shqyrtim çfarëdo përfaqësimesh nga ato Palë Kontraktuese.

6) Në lidhje me tregtinë midis Palëve Kontraktuese ku të paktën një nga të cilat nuk është pjesëmarrëse në OBT, jo për çdo Palë Kontraktuese do të ketë rritje për çdo taksë doganore ose dhe ngarkesave të çdo lloji detyrimi në lidhje me importin ose eksportin e materialeve dhe produkteve të energjisë të listuara në aneksin EM II ose të pajisjeve që lidhen me energjinë listuara në aneksin EQ II rreth nivelet më të ulëta të vendosura në datën e vendimit nga Konferenca e Kartës të listuar çështje të veçanta në aneks.

Një Palë Kontraktuese mund të rrisë çdo taksë doganore ose të tjera detyrime rreth këtij niveli në qoftë se:

a) në rastin e një takse doganore ose të tjera ngarkesa detyruese që lidhen me importin, ku veprime të tilla nuk konfliktohen me dispozitat të aplikueshme të Marrëveshjes së OBT ose me të tjera dispozita të Marrëveshjes së OBT të listuara në aneksin W; ose

b) në rrethana të veçanta jo ndryshe që siguron ky traktat, Konferenca e Kartës vendos të ndalë detyrimet, në qoftë se detyrojnë një Palë Kontraktuese nga ky paragraf, të pranojë një rritje të një takse doganore, që i nënshtrohet çdo detyrimi të Konferencës së Kartës.

7) Pavarësisht paragrafit (6), për rastin e tregtisë i referohemi këtij paragrafi. Palët Kontraktuese që listohen në aneksin BR në lidhje me produktet dhe materialet e energjisë, që listohen në aneksin EM II ose në aneksin BRQ që ka të bëjë me pajisjet që lidhen me energjinë dhe që listohen në aneksin EQ II, nuk do të rrisë asnjë taksë doganore ose detyrim tjetër mbi nivelin që rezulton në marrëveshjet e tyre ose çdo dispozitë të aplikueshme për to nën Marrëveshjen e OBT.

8) Të tjera taksa dhe ngarkesa detyruese ose në lidhje me importimin ose eksportimin të materialeve dhe produkteve të energjisë ose pajisjeve që lidhen me energjinë do t'u nënshtrohen dispozitave të kuptimit në interpretim të nenit II: 1(b) të GATT 1994 i modifikuar sipas aneksit W.

9) Aneksi D do të zbatohet:

a) për mosmarrëveshjet lidhur me respektimin e dispozitave të zbatueshme në tregti sipas këtij neni;

b) për mosmarrëveshjet lidhur me zbatimin nga një Palë Kontraktuese të çdo mase në çdo rast që konfliktin me dispozitat e këtij neni, i cili konsiderohet nga një Palë tjetër Kontraktuese i shfuqizuar ose i dëmshëm çdo përfitim i ngritur në të drekt ose indirekt nën këtë nen ; dhe

c) në rast se Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje nuk vendosin ndryshe për mosmarrëveshjet lidhur me respektimin e nenit 5 ndërmjet Palëve Kontraktuese të paktën njëra prej të cilave nuk është palë në OBT.

Përveçse aneksi D nuk do të zbatohet për asnjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, thelbi i së cilës lind nga një marrëveshje që:

i) është shpallur në përputhje me dhe i përgjigjet kërkesave të tjera të nënparagrafit (2)(b) dhe aneksit TFU; ose

ii) krijon një zonë të lirë tregtare ose një bashkim doganor siç përshkruhet në nenin XXIV të GATT-it 1994.

Neni 2

Traktati do të amendohet si më poshtë:

Në hyrjen, paragrafi shtatë, zëvendësohet “Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë dhe Instrumentet” me “Marrëveshjen e vendosur në OBT”;

Në hyrjen, paragrafi tetë, zëvendësohet “Që lidhet me pajisjet” me “ Pajisjet që lidhen me energjinë”;

Në hyrjen, paragrafi nëntë, zëvendësohet “Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë” me “OBT” dhe “pjesëmarrësit këtu”;

Në hyrjen, paragrafi dhjetë, zëvendësohet “palët të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë dhe Instrumenteve” me “Përfaqësuesit e OBT”;

Neni 1, zëvendësohet në tekst paragrafi (4) me:

"Materiale dhe prodhime energjie", bazuar në Sistemin e Harmonizuar (SH) të Këshillit të Bashkëpunimit të Doganave dhe Nomenklatura e Kombinuar (NK) e Bashkësisë Europiane, do të thotë zërat e përfshira në aneksin EM;

Neni 1, pas ndryshimeve në paragrafin e tekstit (4) bëhet:

(4bis) "Pajisjet që lidhen me energjinë", bazuar në Sistemin e Harmonizuar (SH) të Organizatës Botërore të Doganave, që kupton çështjet e përfshira në anekset EQ I ose EQ II";

Neni 1, zëvendësohet në tekst paragrafi (11) me:

a) "OBT" kupton Organizatën Botërore të Tregtisë krijuar nga marrëveshja që themelon OBT;

b) "Marrëveshja OBT" kupton marrëveshjen që themelon Organizatën Botërore të Tregtisë, me anekset, vendimet, deklaratat dhe kuptimet e saj që lidhen këtu, siç është ratifikuar, amenduar dhe modifikuar kohë pas kohe;

c) "GATT 1994" do të thotë Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë siç është specifikuar në aneksin 1A të marrëveshjes që themelon Organizatën Botërore të Tregtisë siç është ratifikuar, amenduar ose modifikuar kohë pas kohe.

Në nenin 3, pas "Produktet dhe materialet e energjisë" futet "edhe Pajisjet që lidhen me energjinë";

Në nenin 4, titulli, zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së" dhe në tekst të nenit 4, zëvendësohet "palët në GATT" me "Përfaqësuesit e OBT-së" dhe zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së".

Në nenin 5, paragrafi (1), futet "1994" sipas "Nenit III dhe XI të GATT" dhe zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së";

Në nenin 14, paragrafi (6), zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së";

Në nenin 20, paragrafi (1) zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së" dhe pas "Produktet dhe Materialet e Energjisë" futet "edhe Pajisjet që lidhen me energjinë";

Në nenin 21, paragrafi (4), zëvendësohet "Neni 29(2) dhe (6)" me "Nenin 29(2) dhe (8);

Në nenin 25, paragrafi (3), zëvendësohet zëvendësohet "GATT dhe instrumentet e lidhura me të" me "Marrëveshjen e OBT-së";

Në nenin 34, paragrafi (3) shtohet pas nënparagrafi (m):

Merret parasysh dhe aprovohet lista e nënshkrueseve në anekset BR ose BRQ ose të dyja këto anekse;

Merret parasysh dhe aprovohen çështjet e shtuara në aneksin EM II nga aneksi EM I të cilat i korrespondojnë çështjeve të hequra në aneksin EM I dhe merren parasysh dhe aprovohen çështjet e shtuara në aneksin EQ II nga aneksi EQ I të cilat i korrespondojnë çështjeve të hequra në aneksin EQ I;

Në nenin 34, paragrafi (3) zëvendësohet emërtimi i nënparagrafit "(n)" me nënparagrafin "(p)";

Në nenin 36(1)(d), zëvendësohet "G" me "W";

Në nenin 36, në paragrafin (1) pas nënparagrafit (f) shtohet:

g)Aprovohet shtesa në çështjet në aneksin EM II nga aneksi EM I të cilat i korrespondojnë çështjeve të hequra në aneksin EM I dhe aprovohet shtesa në aneksin EQ II nga aneksi EQ I të cilat i korrespondojnë çështjeve të hequra në aneksin EQ I;

Në nenin 36, në paragrafin (4) zëvendësohet "(f) me (g)".

Në tabelën e përmbajtjes të anekseve të Kartës së Energjisë, "Aneksi EM" quhet "Aneksi EM I", dhe futet nga 2 te 4 anekset shtesë "Aneksi EM II Produktet dhe Materialet e Energjisë (në përputhje me nenin 1(4bis))" dhe aneksin EQ I lista e Pajisjeve që Lidhen me Energjinë (me përputhje me nenin 1(4))", dhe "Aneksi EQ II Lista e Pajisjeve që Lidhen me Energjinë (në përputhje me nenin 1 (4bis))".

Në 9. Aneksin G, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”, dhe rriqajta e “Aneksit G” si “Aneksi W”.

Rinumërimi i anekseve 2 deri në 10 si anekset 5 deri në 13. Futja si 14 dhe 15 e anekseve shtesë “Aneksi BR Lista e Palëve Kontraktuese të cilat nuk do të rrisin ndonjë taksë doganore ose detyrime mbi nivelin që rezulton nga marrëveshjet e tyre ose çdo dispozite të pranueshme nga ato nën Marrëveshjen e OBT-së (Në përputhje me nenin 29(7))” dhe “Aneksi BRQ Lista e Palëve Kontraktuese, të cilat nuk do të rrisin ndonjë taksë doganore ose detyrime mbi nivelin që rezulton nga marrëveshjet e tyre ose çdo dispozitë të pranueshme nga ato nën Marrëveshjen e OBT-së (Në përputhje me nenin 29(7))”.

Rinumërimi i anekseve 11 deri te 14 si anekset 16 deri te 19.

Në lidhje me aneksin D, zëvendësohet “(në përputhje me nenin 29(7))” me “(Në përputhje me nenin 29 (9))”.

Në aneksin EM, "EM" quhet "EM I".

Në aneksin TRM, paragrafi (1)(a) dhe (b) dhe në paragrafin (3)(a) dhe (b), zëvendësohet "pjesëmarrës i GATT" me "pjesëmarrës i OBT-së".

Në aneksin TFU, paragrafët (2)(c), (4), fjalinë e parë, dhe (6), fjalia e parë, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

Neni 3

Aneksi D i traktatit do të amendohet si më poshtë:

Në titull zëvendësohet “(në përputhje me nenin 29(7))” me “(Në përputhje me nenin 29 (9))”.

Në fund të paragrafit (1)(a), fshihet perioda dhe shtohet pas kësaj duke ndjekur "29":

", ose rreth çdo masave që mund të shfuqizojnë ose dëmtojnë çdo përfitim të ngritur nga një Palë Kontraktuese direkt ose indirekt nën dispozitat e aplikueshme të tregtisë nën nenin 29”

Në paragrafin (1)(b), në fund të fjalisë së parë, fshihet periudha dhe futet pas kësaj sipas “29”:

", ose çdo masë që mund të shfuqizojnë ose dëmtojnë çdo përfitim i ngritur nga një Palë Kontraktuese direkt ose indirekt nën dispozitat e aplikueshme të tregtisë nën nenin 29”

Dhe në fjalinë e dytë, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

Në paragrafin (1)(d), futet pas presjes përpara "Palët Kontraktuese":

"ose të shfuqizojnë ose dëmtojnë çdo përfitim të ngritur direkt ose indirekt nën dispozitat e aplikueshme të tregtisë nën nenin 29”.

Në paragrafin (2)(a), fjalia e dytë, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

Në paragrafin (3)(a), fjalia e dytë, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

dhe zëvendësohet fjalia e parafundit me:

"Panelet do të drejtohen nga interpretuesit që mbështeten nga Marrëveshja e OBT-së brenda kuadrit të Marrëveshjes së OBT-së dhe nuk do të ketë pyetje për përshtatjen e praktikave të nenit 5 ose 29 mbështetur nga çdo Palë Kontraktuese, e cila është pjesëmarrëse e OBT-së dhe të tjerë pjesëmarrës OBT-së të cilët e mbështesin Marrëveshjen e OBT-së dhe që nuk e kanë marrë atë si e tjerë pjesëmarrës për zgjidhjen e vendimeve nën Marrëveshjen e OBT-së”.

Në paragrafin (4)(b), fjalia e parë, zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

Në paragrafin (5)(c), zëvendësohet “GATT dhe instrumentet e lidhura me të” me “Marrëveshjen e OBT-së”.

Në paragrafin (7), fjalia e parë, zëvendësohet "pjesëmarrës i GATT" me "pjesëmarrës i OBT-së"

Dhe zëvendësohet “panelistët aktualisht që emërohen për qëllimet e GATT-it për zgjidhjen e panelit” me:

"personat emrat e të cilëve shpallen në listë qeveritare ose individualisht jo qeveritar referuar nenit 8 të Rregullave të Kuptimit dhe të Procedurave Qeveritare për Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve siç paraqiten në aneksin 2 të Marrëveshjes së OBT-së ose kush ka shërbyer në të kaluarën si panelist në GATT ose në OBT në panelin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.”

Shtohet pas paragrafit (9):

10. Ku një Palë Kontraktuese i referohet nenit 29(9)(b), subjekt i modifikimeve të mëposhtme, ky aneks do të mbështesë :

a) “Ankesën e palës që do të paraqesë në detaj justifikimin në mbështetjen e çdo kërkesë për konsultime ose për vendosjen e një paneli në lidhje me një masë e cila ka parasysh që të shfuqizojnë ose dobësojë çdo përfitim i ngritur direkt ose indirekt nën dispozitat e aplikueshme të tregtisë në nenin 29”.

b) Kur një masë ka qenë vendosur të shfuqizohet ose të dobësohet përftuar nga neni 29 pa detyrim këtu, nuk është detyruese të tërheqësh masën; sidoqoftë në këtë rast paneli do të rekomandojë që Pala Kontraktuese ankimuese të bëjë një axhustim të kënaqshëm reciprok;

c) Paneli arbitral që kushtëzohet në paragrafin (6)(b) në kërkesën e çdo pale kontraktuese, mund të përcaktohet niveli i përfitimeve që janë shfuqizuar ose dobësuar, dhe mundet gjithashtu të sugjerohen rrugët dhe mënyrat e arritjes së një axhustimi të kënaqshëm reciprok; sygjerimet e tilla nuk do të detyrojnë palët në konflikt.

b) kur një masë është marrë për të anuluar ose ulur dëmtimin e të ardhurave, që vjen nga shkelja e nenit 29, nuk ka asnjë obligim për t’u tërhequr nga kjo masë, megjithatë, në këtë rast grupi pjesëmarrës do të japë rekomandimet që Pjesa Kontraktuese është e interesuar të bëjë rregullimet reciprokisht të kënaqshme.

c) grupi i arbitrazhit i pajisur me paragrafin (6) (b), në kërkesë të secilës palë, mund të sygjerojë gjithashtu drejtimit dhe mënyrat e arritjes së një rregullimi reciprokisht të kënaqshëm; sygjerime të tilla tregojnë që nuk kanë lidhje me pjesët të këtij debati.

Neni 4

Anekset në vazhdim do të zëvendësojnë aneksin G të Marrëveshjes:

ANEKS W

PËRJASHTIMET DHE RREGULLAT KRYESORE TË ZBATIMIT TË MASAVE TË MARRËVESHJES WTO (NË PËRPUTHJE ME NENIN 29 (2) (A))

(A) Përfashtimet në Zbatimin e Masave të Marrëveshjes WTO.

Masat në vazhdim të Marrëveshjes WTO nuk do të jenë të zbatueshme sipas 29(2) (a):

1) Marrëveshja e themelimit të Organizatës Botërore të Tregtisë

Të gjitha, përveç nenit IX, paragrafët 3 dhe 4, neni XVI, paragrafët 1, 3 dhe 4

a) Aneks 1A tek Marrëveshja e WTO:

Marrëveshjet e Shumanshme në Tregti në Përfitime:

i) Marrëveshja e Përgjithshme në Tarifa dhe Tregti në vitin 1994

II Lista e Koncesioneve, paragrafët (1)(a), (1)(b), (1)(c) dhe (7)

IV Masat Speciale lidhur me Filmat Kinematografikë

XV Marrëveshjet e Shkëmbimit

XVIII Asistenca Qeveritare në Zhvillimin Ekonomik

XXII Konsultimet

XXIII Shfuqizimet dhe dëmet

XXIV Unionet e Klientëve dhe Zonat e Tregtisë së Lirë, paragrafi 680

XXV Veprimet e Përbashkëta nga Palët Kontraktuese

XXVI Pranimi, Hyrja në Forcë dhe Regjistrimi

XXVII Refuzimi dhe tërheqja e koncesioneve

XXVIII Modifikimi i skeduleve
 XXVIII Negociatat për tarifat
 XXIX Relacioni i kësaj Marrëveshjeje në Sekretariatin e Havanës
 XXX Amendamentet
 XXXI Tërheqja
 XXXII Palët Kontraktuese
 XXXIII Shtimi (hyrjet)
 XXXV Joaplikuesit të Marrëveshjes midis Palëve të Kontraktuesve të Veçantë
 XXXVIParimet dhe objektivat
 XXXVII Angazhimet
 XXXVIII Veprimet e përbashkëta
 Aneks H Lidhur me nenin XXVI
 Aneks IVërejtjet dhe Masat Plotësuese (lidhur me masat e përmendura nga GATT)
 Duke u mbështetur në interpretimin e nenit II : 1(b) të GATT të vitit 1994
 2. Data e përfshirjes së detyrave të tjera dhe ngarkesave brenda skedulit
 4 Sfidat, (vetëm sentenca e parë)
 6 Kundërshtimi i Marrëveshjeve
 8 Seancat super (shitesë) të BISD 27S/24
 Duke u mbështetur në interpretimin e nenit XVII të GATT, i vitit 1994
 1 vetëm fraza “ për rishikimin nga Grupi i Punës të jetë filluar sipas paragrafit (5)
 5 Grupi i Punës në kuadër të tregtisë
 80 shiko Aktin Final të Konferencës Internacionale
 Duke u mbështetur në Bilancin e Pagesave të Masave të GATT, i vitit 1994
 5 Komisioni për Bilancin e Pagesave Kufizuese, përveç sentencës së fundit
 7 Rishikim nga Komisioni, të frazës “ose sipas paragrafit 12(b) të Nenit XVIII”
 8 Procedurat e thjeshtëzuara të konsultimeve
 13 Konkluzionet e konsultimeve të Bilancit të Pagesave, sentenca e parë, sentenca e tretë:
 fraza “ dhe XVIII: B, të Deklaratës së vitit 1979” dhe sentenca e fundit.
 Duke u mbështetur në interpretimin e nenit XXIV të GATT, i vitit 1994
 Të gjitha, përveç paragrafit 13
 Duke u mbështetur në Respektimin e Obligimeve nga Dorëheqja sipas GATT të vitit 1994
 3 Shfuqizimet dhe dëmet
 Duke u mbështetur në interpretimin e nenit XXVIII të GATT, i vitit 1994
 Protokollin e Marrakeshit të GATT të vitit 1994
 ii) Marrëveshja për Agrikulturën
 iii) Marrëveshja për Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare
 iv) Marrëveshja për Tekstilet dhe Veshjet
 v) Marrëveshja për Barrierat Teknike në Tregti
 Parathënia (paragrafi 1, 8, 9)
 1.3 Masat e përgjithshme
 10.5 Fjalët “Vendet e zhvilluara” dhe “Franceze ose Spanjolle” të cilat do të zëvendësohen nga fjala “Ruse”
 10.6 Fraza “dhe tërheqja e vëmendjes së anëtarëve të vendeve në zhvillim në interes të tyre.
 10.9 Informacion rreth rregullave teknike, standardeve dhe sistemeve të certifikimit (gjuhët)
 11 Asistenca teknike tek pjesëtarët e tjerë
 12 Trajtimet speciale dhe të diferencuara të vendeve në zhvillim
 13 Komiteti i Barrierave Teknike në Tregti
 14 Konsultimi dhe Debatimi për Marrëveshjen
 15 Masat Finale (të tjera veç 15.2 dhe 15.5)
 Aneks 2 Grupi i ekspertëve teknikë
 vi) Marrëveshja për masat lidhur me investimet në tregti
 vii) Marrëveshja për zbatimin e nenit VI të GATT, i vitit 1994 (Anti-damping)

15 Anëtarët e Vendeve në Zhvillim
16 Komiteti për Praktikën Anti –Damping
17 Konsultimi dhe Debati për Marrëveshjen
18 Masat Finale, paragrafi 2 dhe 6
viii) Marrëveshja për Zbatimin e Nenit VII të GATT, i vitit 1994 (përcaktimi i vlerës së taksave doganore)
Parathënia, paragrafi 2, fraza “dhe të sigurojë të ardhura shtesë për tregtinë ndërkombëtare të vendeve në zhvillim”
14 Zbatimi i Anekseve (sentenca e dytë, përveç asaj që i referohet Aneksit III, paragrafëve 6 dhe 7)
18. Institucionet (Komisioni i Vlerësimit të Taksave Doganore)
19. Konsultimi dhe Debati për Marrëveshjen
20. Trajtimet speciale dhe të diferencuara të vendeve në zhvillim
21. Kufizimet
23. Rishqyrtimi
24. Sekretariati
Aneks II Komisioni Teknik i Vlerësimit të Taksave Doganore
Aneks III Masat shtesë (përveç paragrafëve 6 dhe 7)
(ix) Marrëveshja e Kontrollit Paratransportues Parathënia, paragrafi 2 dhe 3
3.3 Asistenca Teknike
6. Rishikimi
7. Konsultimi
8. Debati mbi marrëveshjen
(x) Marrëveshja mbi Rregullat dhe Burimet Parathënia, kryeradha e tetë
4 Institucionet
6 Rishikimi
7 Konsultimi
8 Debati mbi Marrëveshjen
9 Harmonizimi i Rregullave të Burimeve
Aneks I Komisioni Teknik për Rregullat të Burimeve
(xi) Marrëveshja mbi Procedurat e Licencimit të Importit
1.4(a) Masat e përgjithshme (sentenca e fundit)
2.2 Licencimi i Importit të Automatizuar (shënimi 5 në fund)
3.5 (iv) Licencimi i Importit jo të Automatizuar (sentenca e fundit)
4 Institucionet
6 Konsultimi dhe Debati mbi Marrëveshjen
7 Rishikimi (përveç paragrafit 3)
8 Masat finale (përveç paragrafit 2)
(xii) Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese
4 Kompensimet (përveç paragrafëve 4.1, 4.2 dhe 4.3)
5 Efektet e kundërta, sentenca e fundit
6 Pasojat serioze (paragrafët 6.6, fraza “subjekt i masave të paragrafit 3 të Aneksit V” dhe “rrjedh nga Neni 7, dhe në grupin e themelimit në vijim të paragrafit 4 të Nenit 7”, 6.8 fraza “përfshirë informacionin e paraqitur në përputhje me masat e Aneksit V” dhe 6.9)
7 Kompensimet (përveç paragrafëve 7.1, 7.2 dhe 7.3)
8 Identifikimi i Subvencioneve të paaktivizuara, paragrafi 8.5 dhe shënimi 25 në fund
9 Konsultimet dhe Kompensimet e Autorizuara
24 Komisionet për Subvencionimet dhe Trajtimet e Diferencuara të Anëtarëve të Vendeve në Zhvillim
26 Survejimi
27 Trajtimet Speciale dhe të Diferencuara të Anëtarëve të Vendeve në Zhvillim
29 Transformimi brenda Ekonomisë së Tregut

- 30 Debati mbi Marrëveshjen
- 31 Zbatimi i Masave
- 32.2, 32.7 dhe 32.8 (vetëm siç i referohet anekseve V dhe VII) Masat Finale
- Aneks V Procedurat për Zhvillimin e Informacionit në lidhje me Pasojat Serioze
- Aneks VII Vendet në Zhvillim
- xiii) Marrëveshja mbi Sigurinë
- 9 anëtarët e vendeve në zhvillim
- 12 Informimi dhe Konsultimi, paragrafi 10
- 13 Survejimi
- 14 Marrëveshja e Debatuar
- Aneks përjashtimet
- b) Aneks 1B tek Marrëveshja e WTO-së Marrëveshja e Përgjithshme e Tregtisë në Shërbime
- c) Aneks 1C tek Marrëveshja e WTO-së Marrëveshja në Tregti -Lidhur me Aspektet e të Drejtave të Autorit
- d) Aneks 2 tek Marrëveshja e WTO-së Duke u mbështetur në Rregullat dhe Procedurat e Qeverisë për Marrëveshjet e Diskutuara
- e) Aneks 3 tek Marrëveshja e WTO-së
- Mekanizmat e Rishikimit të Politikave Tregtare
- f) Aneks 4 te Marrëveshja e WTO-së Marrëveshjet Tregtare Shumëpalëshe:
- i) Marrëveshja mbi Tregtinë e Transportit Ajror Civil
- ii) Marrëveshja mbi Procedurat e Qeveritare
- g) Vendimet Ministrore, Deklaratat dhe Mirëkuptimet:
- i) Vendimet mbi masat në favor të vendeve më pak të zhvilluara
- ii) Deklarata mbi kontributin e WTO-së në realizimin më të lartë të zhvillimit të politikave të ekonomisë globale
- iii) Vendimi mbi Procedurat e Shpallura
- iv) Deklarata mbi marrëdhëniet reciproke të WTO-së me IMF
- v) Vendimi mbi Masat lidhur me Efektet Negative të Mundshme të Programit të Reformave në Vendet më pak të Zhvilluara dhe Importuese neto të Ushqimeve
- vi) Vendimi mbi Shpalljen e Integritit të Parë sipas nenit 2.6 të Marrëveshjes mbi Tekstilet dhe Veshjet
- vii) Vendimi mbi Rishikimin e ISO/IEC të Publikimeve të Qendrës së Informimit
- viii) Vendimi mbi Marrëveshjen e Propozuar të Mirëkuptimit për Standardet e WTO- ISO të Sistemit të Informacionit
- ix) Vendimi mbi Ani- Mashtrimin
- x) Vendimi mbi Rishikimin e nenit 17.6 të Marrëveshjes mbi zbatimin e nenit VI të GATT të vitit 1994
- xi) Deklarata mbi Marrëveshjen e debatuar në vijim të Marrëveshjes mbi implementimin e nenit VI të GATT të vitit 1994 të pjesës V të Marrëveshjes mbi subvencionet dhe masat kundërvepruese
- xii) Vendimi lidhur me rastet ku administratorët e klientëve kanë arsye të dyshojnë në vërtetësinë ose saktësinë e vlerave të deklaruara
- xiii) Vendimi mbi tekstet lidhur me minimumin e vlerave dhe importeve nga mjetet e veçanta, shpërndarësit e veçantë dhe koncensionarët e veçantë
- xiv) Vendimi mbi Marrëveshjet Institucionale për GATS
- xv) Vendimi mbi besueshmërinë e procedurave të Marrëveshjes së Diskutuar për GATS
- xvi) Vendimi mbi tregtinë në shërbime dhe mjedis
- xvii) Vendimi mbi negociimet për lëvizjen e lirë të njerëzve
- xviii) Vendimi mbi shërbimet financiare
- xix) Vendimi mbi negociatat për Shërbimet e Transportit Detar
- xx) Vendimi mbi Negociatat për Telekomunikacionin Bazë

xxi) Vendimi mbi shërbimet profesionale
xxii) Vendimi mbi të Drejtat në Marrëveshjen e Prokurimeve Qeveritare
xxiv) Vendimi mbi Zbatimin dhe Rishqyrtimin e Rregullave të Mirëkuptimit dhe Procedurave Qeveritare të Deklaratës së Diskutuar
xxv) Mirëkuptimi mbi angazhimet në Shërbimet Financiare
xxvi) Vendimi mbi pranimin dhe të drejtat te Marrëveshja e Themelimit të WTO
xxvii) Vendimi mbi tregtinë dhe mjedisin
xxviii) Vendimi mbi pasojat financiare dhe organizative që vijnë nga implementimi i marrëveshjes së themelimit të WTO-së

xix) Vendimi mbi themelimin e Komitetit Përgatitor për WTO-në

Të gjitha kushtet e tjera mbi Marrëveshjen e WTO-së të cilat lidhen me:

a) Asistencën qeveritare në zhvillimin ekonomik dhe trajtimin e vendeve në zhvillim, përveç paragrafëve (1) deri tek (4) të vendimit të 28 nëntorit 1979 (L/4903) mbi trajtimet e diferencuara dhe më shumë të favorizuara, reciprociteti dhe pjesëmarrja e plotë e vendeve në zhvillim;

b) Themelimi apo puna e specializuar e Komitetit dhe e institucioneve të tjera ndihmëse;

c) Firmat, ardhjet, hyrja në forcë, tërheqja, depozitimi dhe regjistrimi.

3) Të gjitha marrëveshjet, ujditë, vendimet, mirëkuptimet apo veprimet e përbashkëta pasuese të kushteve të listuara si jo të aplikueshme mbi paragrafin (1) ose (2)

4) Tregtia për materialet nukleare mund të jetë qeverisur nga marrëveshje referuar në deklaratat të lidhura me këto paragrafë që i përmbahen Aktit Final të Konferencës së Kartës Europiane të Energjisë.

B. Rregullat Qeveritare të Zbatimit për Kushtet e Marrëveshjes së WTO

1) Në mungesë të një interpretimi të përshtatshëm të Marrëveshjes së WTO të miratuar nga Konferenca Ministrore të Këshillit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Tregtisë sipas paragrafit 2 të nenit IX të Marrëveshjes së WTO në lidhje me kushtet e aplikuara sipas nenit 29(2)(a), Konferenca e Kartës mund të adoptojë një interpretim.

2) Kërkesat për dorëheqje sipas nenit 29(2) dhe (6)(b), do të jenë mbledhur në Konferencën e Kartës, e cila do të ndjekë zbatimin e këtyre detyrave, procedurat e paragrafit 3 dhe 4 të nenit IX të Marrëveshjes së WTO-së.

3) Heqja dorë nga obligimet në fuqi të WTO-së do të konsiderohen në fuqi për qëllime të nenit 29 ndërkohë që ato vazhdojnë të jenë në fuqi në WTO.

4) Kushtet e nenit II të GATT të 1994 të cilat kanë tregues jo të dukshme, pa pasoja në nenin 29(4), (5) dhe (7) janë modifikuar si në vazhdim:

i) Të gjitha materialet dhe produktet energjetike të listuara në aneksin EM II dhe pajisjet e lidhura me energjinë listuar në aneksin EQII të importuara apo eksportuara në ndonjë Pjesë tjetër Kontraktuese do të jenë gjithashtu të çliruara nga të gjitha detyrimet apo ngarkesat e tjera të ndonjë lloj sanksioni apo lidhjeje me importin apo eksportin, në përmbajtje të këtyre sanksioneve mbi datën e ndalesës referuar nenit 29(6), sentenca e parë, ose sipas nenit 29(7), ose ato në mënyrë direkte dhe të mandatuar kërkohet të jenë sanksionuar pas kësaj nga legjislacioni në fuqi në vendet importuese apo eksportuese në datën referuar nenit 29(6), sentenca e parë.

ii) Asnjë gjë në nenin II të GATT 1994 nuk do të pengojë ndonjë Palë Kontraktuese me sanksione gjatë kohës së importimit dhe eksportimit të ndonjë produkti:

a) një ngarkesë ekuivalente mbi një taksë të brendshme sanksionon në përputhje me kushtet e paragrafit 2 të nenit III të GATT 1994 në lidhje me produktet shtëpiake apo në lidhje me një nen prej të cilit produktet e importuara kanë qenë prodhuar ose përgatitur plotësisht ose pjesërisht;

b) ndonjë anti-damping apo taksë kundërvepruese aplikohet me kushtet e nenit VI të GATT 1994;

c) tarifat apo ndalesat të krahasueshme me kostot e shërbimeve paguhen;

iii) Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të ndryshojë metodat e tyre për përcaktimin e vlerave të taksave apo konvertimit të parave deri në dëmtimin e vlerës së obligacioneve të ndalura, të siguruara në nenin 29(6) ose (7).

iv) Në qoftë se ndonjë Palë Kontraktuese themelon, mbron apo autorizon, formalisht apo në mënyrë efektive, një monopol të eksportimit apo importimit të ndonjë materiali apo produkt energjetik të listuar në aneksin EM II ose në përputhje me pajisjet –përdoruese të energjisë të listuara në aneksin EQ II, që si monopol nuk operon deri sa të jetë në gjendje të mbrojë në nivel mesatar tejkalimin e vlerës së mbrojtjes së autorizuar nga obligacionet e ndalura, të siguruara nga në nenin 29(6) ose (7). Kushtet e këtij paragrafi nuk do të limitojnë përdorimin nga Palët Kontraktuese të ndonjë forme asistence të prodhuese shtëpiake të lejuara nga kushtet e tjera të kësaj kontrate.

v) Në qoftë se ndonjë Palë Kontraktuese merr parasysh që një produkt nuk është pranuar nga Pala tjetër Kontraktuese, kontrata të cilën Pala e parë Kontraktuese beson se ka qenë e kompletuar nga obligacionet e ndalura të siguruara nga neni 29(6) ose (7), ato do të merren si material direkt në vëmendje të Palës tjetër Kontraktuese. Në qoftë se më vonë bihet dakord që kontrata të kompletohet siç u pretendua nga Pala e parë Kontraktuese, por që deklaron se kontrata nuk mund të bjerë dakord, sepse një gjykatë ose një autoritet tjetër ka rregulla me efekt në atë që produkti i përfshirë në këtë kontratë nuk është i klasifikuar në ligjin tarifor të kësaj Pale Kontraktuese deri në lejimin e kontratës së kompletuar të kësaj kontrate, të dyja Palët Kontraktuese së bashku me ndonjë Palë tjetër Kontraktuese në thelb e interesuar, do të hyjë me shpejtësi brenda negociatave të mëtejshme me një pasqyrë të rregullimeve kompensuese të përmbajtjes.

vi) a) Taksat doganore specifike dhe ndalesat, të përfshira në Protokollin e Tarifave lidhur me anëtarët e Palëve Kontraktuese të Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe kufizimi në preferencat e taksave doganore dhe ndalesave të mbajtura ndaj këtyre Palëve Kontraktuese, janë pasqyruar në monedhën e përshtatshme me vlerë nominale të pranuar ose miratuar provizorisht nga Fondi në datën e ndalesës referuar nenit 29(6), sentenca e parë, ose sipas nenit 29(7). Prandaj, në rast se kjo vlerë nominale është reduktuar në përputhje me nenin e Marrëveshjes të Fondit Monetar Ndërkombëtar më shumë se 20% (njëzet për qind), atëherë marxhinat e referencave mund të rregullohen duke marrë parasysh këtë reduktim;

Të siguruara nga konkursi i kësaj Konference këto rregullime nuk do të dëmtojnë vlerën e obligacioneve të ndalura, të siguruara nga neni 29(6) ose (6) apo nga tjetër nen i këtij Traktati, për shkak të llogaritjes së nxjerrë nga të gjithë faktorët të cilët kanë influencuar për nevojën urgjente të këtyre rregullimeve.

b) Kushte të ngjashme do të aplikohen edhe tek ndonjë Palë Kontraktuese që nuk është anëtare e Fondit, që nga data në të cilën Pala Kontraktuese do të bëhet anëtare e Fondit ose do të hyjë brenda një marrëveshjeje speciale këmbimi në përputhje me nenin XV të GATT 1994.

vii) Secila Palë Kontraktuese do të paraqesë një notë ose kërkesë në Sekretariatit për taksat doganore dhe ndalesat e doganave për ndonjë lloj zbatimi në datën e ndalesave referuar nenit 29(6), sentenca e parë. Sekretariati do të mbajë një raport tarifash të taksave dhe ndalesave të doganave lidhur me destinacionin e ndalesave të taksave dhe pagesave doganore të këtij lloji sipas nenit 29(6) ose (7).

5) Vendimi i 26 Marsit 1980 në “Paraqitja e një Sistemi Loose-Leaf për Skedulet e Tarifave të Koncesioneve” (BISD 27S/24) nuk do të aplikohet sipas nenit 29(2)(a). Masat e aplikuara të Marrëveshjes së Mirëkuptimit në interpretim të nenit II:1(b) të GATT 1994, pa asnjë paragjykim të nenit 29(4), (5) ose (7), do të aplikohet me modifikimet e mëposhtme:

i) Në mënyrë që të sigurohet transparenca e vendimeve legale dhe obligimeve që derivojnë nga paragrafi 1(b) të nenit II të GATT 1994, natyra dhe niveli i ndonjë “e taksave doganore dhe pagesave” të lëvruara mbi ndonjë material dhe produkt të listuar në aneksin EM II të pajisjeve të lidhura me energjinë të listuara në aneksin EQ II në përputhje me importin dhe eksportin e tyre, siç është treguar në këtë masë, do të rakordohen në Pasqyrën e Tarifave në nivelet e zbatimit në datën e ndalesave duke u referuar respektivisht në nenin 29(6), sentenca e parë, ose sipas nenit 29(7), kundrejt tarifave të artikujve tek të cilët do të aplikohet. Kjo nënkupton atë që të dhënat nuk do të ndryshojnë karakterin ligjor të “taksave doganore dhe pagesave”.

ii) “Taksat doganore dhe pagesat e tjera” do të jenë regjistruar në përputhje me të gjitha materialet dhe produktet e listuara në aneksin EM II dhe pajisjet e lidhura me energjinë të listuara në aneksin EQ II.

iii) Kjo do të jetë e hapur për ndonjë Palë Kontraktuese për të sfiduar ekzistencën e ndonjë “takse doganore dhe pagesë tjetër”, në bazë të asaj “takse doganore dhe pagese tjetër” që ekziston në datën e ndalesave referuar në nenin 29(6), sentenca e parë ose i lidhur me datën sipas nenit 29(7), për artikujt e çështjes në fjalë, në mënyrë konsistente me nivelin e të dhënave të ndonjë “takse doganore dhe pagesë tjetër” me obligacine të ndalura të siguruara sipas nenit 29(6) ose (7), për një periudhë prej një viti pas hyrjes në fuqi të amendamentit të masave lidhur me tregtinë të këtij Traktati, të miratuar nga Konferenca e Kartës në 24 prill 1998, ose një vit pas shpalljes në Sekretariat të nivelit të taksave dhe pagesave doganore që i referohen nenit 29(6), sentenca e parë ose Nenit 29 (7) në qoftë se është më e vonshme.

iv) Rakordimi i “taksës doganore dhe pagesës tjetër” në Pasqyrën e Tarifave është pa paragjykitime në konsekuencën e saj me të drejtat dhe obligacionet sipas GATT 1994 të tyre të influencuara nga nënparagrafi (iii) i mësipërm. Të gjitha Palët Kontraktuese ruajnë të drejtën të ndryshojnë, në ndonjë kohë, në përputhje të ndonjë “taksë doganore dhe pagesë tjetër” këto obligime.

v) “Taksa doganore dhe pagesa tjetër” të harruara nga shpallja e Sekretariatit nuk do të shtohet më pas dhe ndonjë “taksë doganore dhe pagesë tjetër” e raportuar në nivele më të ulëta se ato ekzistuese në datën e zbatimit nuk do të kthehen në atë nivel vetëm në qoftë se këto shtesa dhe pagesa janë bërë brenda gjashtë muajve të shpalljes në Sekretariat.

6) Kur Marrëveshja e WTO-së referohet mbi “taksat doganore të përshkruara në skedule” ose në “taksat doganore kufi”, kjo do të zëvendësohet me “niveli i taksave dhe pagesave doganore të ndonjë lloji të lejuara nga neni 29(4) deri tek (8)”.

7) Kur Marrëveshja e WTO-së specifikon datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së WTO-së (ose një frazë analoge) si datë reference për veprim, ajo do të jetë zëvendësuar me datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes mbi masat lidhur me tregtinë të këtij Traktati të miratuar nga Konferenca e Kartës në 24 prill 1998.

8) Në përputhje me vërejtjet e nevojshme mbi masat e marra të aplikuara sipas nenit 29(2)(a):

a) Palët Kontraktuese të cilat nuk janë anëtare të WTO-së do t’i çojnë vërejtjet e tyre në Sekretariat. Sekretariati do të qarkullojë kopjet e vërejtjeve të të gjitha Palëve Kontraktuese. Vërejtjet në Sekretariat do të jenë në njërin nga gjuhët autentike të këtij Traktati. Dokumentet shoqëruese do të jenë vetëm në gjuhën e Palës Kontraktuese;

b) Këto kërkesa nuk do të aplikohen në Palët Kontraktuese të këtij traktati, të cilat janë gjithashtu anëtare të WTO-së e cila siguron për ta kërkesat për vërejtjet e tyre.

9) Kur neni 29(2) (a) ose (6)(b) aplikohet, Konferenca e Kartës do të shpallë ndonjë taksë doganore që Marrëveshja e WTO-së ka përfunduar lidhur me organizmat nën Marrëveshjen e WTO-së.

10) (a) Interpretimet e Marrëveshjes së WTO-së të miratuara nga Konferenca Ministrore e Këshillit të Përgjithshëm të WTO-së sipas paragrafit të 2 të nenit IX të Marrëveshjes së WTO-së që deri tani interpretojnë masat e dala sipas nenit 29(2)(a) do të aplikohen.

b) Amendamentet e Marrëveshjes së WTO-së sipas nenit X të Marrëveshjes së WTO-së, të cilat kanë lidhje me të gjithë anëtarët e WTO (të tjerë që janë sipas paragrafit 9 të nenit X) që deri tani janë amenduar ose masat lidhur me to të aplikuara sipas nenit 29(2)(a), do të aplikohen vetëm kur një Palë Kontraktuese i kërkon Konferencës së Kartës të mos zbatojë ose t’i modifikojë këto amendamente. Konferenca e Kartës do të marrë një vendim për tre-katër pika kryesore të Palëve Kontraktuese dhe përcakton datën e moszbatimit apo të modifikimit të këtyre amendamenteve. Në kërkesë të kësaj, moszbatimi apo modifikimi i këtyre amendamenteve do të përfshijë një kërkesë që zbatimi i amendamentit të jetë pezulluar deri në pritje të vendimit të Konferencës së Kartës.

Në kërkesë të kësaj, Konferenca e Kartës, sipas këtij paragrafi shpall brenda gjashtë muajve të qarkullimit të vërejtjeve nga Sekretariati, që amendamenti ka bërë efekt sipas Marrëveshjes së WTO-së.

c) Interpretimet, amendamentet apo instrumentet e reja të miratuara nga WTO, të tjerat që interpretohen dhe amendohen mbështetur në paragrafët (a) dhe (b) nuk do të aplikohen.

Neni 5

Anekset e mëposhtme do të jenë pjesë e anekseve të Traktatit:

2. ANEKSI EM II MATERIALET DHE PRODUKTET E ENERGIJË

(Në përputhje me nenin 1(4))

3. ANEKSI EQ I LISTA E PAJISJEVE ENERJETIKE

(Përsëri në përputhje me nenin 1(4))

Për qëllim të këtij aneksi “Shpjegimet (Ex)” përdoren për të treguar që përshkrimi i produktit nuk i referohet shkarkimeve për të gjithë gamën e produkteve brenda titujve të Nomenklaturës së Organizatës Botërore të Doganave ose kodeve të Sistemit të Harmonizuar të regjistruara më poshtë.

Shpjegimi (Ex) 39.19 Pllaka vetëngjitëse, fletë, fletë film, tapet, shirit, dhe të tjerë të formës së sheshtë, prej plastike, qofshin ose jo në formë rrathësh.

Shpjegimi 3919.10 - në rulonë me gjerësi që nuk kalojnë 20 cm

- përdoren në tubacionet e naftës dhe gazit si dhe në mbrojtëset e linjave detare

Shpjegimi 73.04* Tuba dhe profile të mbyllur, pa tegel, prej hekuri (të ndryshëm nga giza e derdhur) ose prej çeliku

- Tuba linjash që përdoren për linjat e naftës ose gazit

Tuba të derdhur, shpuar, trollues që përdoren në shpimet e naftës ose gazit

7304.21 -Tuba shpimi

7304.29 - të tjerë

Shpjegimi 73.05 Tuba të tjerë (p.sh. të salduar, të perçinosur ose të ngjashëm në mbyllje), që kanë seksion tërthor, rrethor me diametër të jashtëm mbi 406.4 mm, prej hekuri ose çeliku.

Tuba linjash të llojit që përdoren për linjat e N-G

- Me tegel gjatësor të kryer me hark elektrik të zhytur

- Të tjerë të salduar për së gjati

7305.19 -Të tjerë

7305.20 -Tuba të tjerë të llojit që përdoren në shpimet për naftë ose gaz

Shpjegimi 73.06* Të tjerë tuba dhe profile të mbyllur (p.sh. Të hapur ose me tegel të salduar, të perçinosur ose me mbyllje të ngjashme), prej hekuri ose çeliku.

- tuba linje të llojit që përdoren për tubacione naftë ose gazi

- tuba të derdhur ose trolluar të llojit që përdoren në shpimet për naftë ose gaz

- tuba ose rakorderi (p.sh. Mufta, kthesa, reduksione) prej hekuri ose çeliku

Shpjegimi 73.08 Struktura (përfshijon ndërtesat parafabrikate të kreut nr.94.06) dhe pjesë të strukturave (p.sh. ura, seksione urash, porta shiber, kulla, krah bigash, rrjeta, dysheme, çati, kapriata çatish, dyer, dritare dhe kornizat e tyre, si dhe kollona, krahë shtylla) prej hekuri ose çeliku, sheshe, rrugë, kënde, seksione, tubacione e të ngjashme që përgatiten për konstruksionet prej hekuri ose çeliku.

7308.20- kulla dhe krah bigash

7308.40-pajisje për skaferi, grila, sheshe-shkallë avarie

Shpjegimi 7308.90 - të tjera - Pjesë të platformave të shpimit për N-G

Shpjegimi 73.09 Rezervuare, tankera, vaska dhe kontenierë të ngjashëm për çdo lloj

lëndë (të ndryshëm nga gazi i lëngët ose i komprinuar), prej hekuri ose çeliku me kapacitet mbi 300 litra, qoftë ose jo i veshur ose i termoizoluar, por që nuk lidhet me pajisje mekanike ose termike.

Shpjegimi 7309.00 - për lëngje

- me kapacitet mbi 1,000,000 l ku projektohet posaçërisht për rezerva strategjike naftë

- të termoizoluar
- Shpjegimi 73.11-kontenierë për gaz të komprimuar ose të lëngështuar, prej hekuri ose çeliku
 - me kapacitet mbi 1000 litra
- Shpjegimi 73.12* - tela, kavo, kabëll, shirita të veshur, litarë, etj., që janë në kushte të vështira, prej hekuri ose çeliku të pa izoluar elektrikisht.
- Shpjegimi 73.12.10- tela, kablo, kavo në kushte të vështira pune
 - kavo dhe kablo të veshura, të zhveshura ose të zinkuara të llojeve që përdoren në sektorin energjetik;
- Shpjegimi 73.26 të tjerë artikuj prej hekuri ose çeliku
- Shpjegimi 73.26.90-Të tjerë
 - Bashkues për kabllot me fibra optike
- Shpjegimi 76.13 Kontenierë prej alumini që mbajnë gaz të kompresuar ose të lëngështuar me kapacitet mbi 1000 litra.
- Shpjegimi 76.14 Tela, kablo, shirita të veshur dhe të ngjashëm me ta, prej alumini, por të pa izoluar elektrikisht.
- Shpjegimi 76.14.10- me zemër çeliku
 - po njëllon me atë që përdoret në gjenerimin e elektricitetit në transmetim dhe shpërndarje
- Shpjegimi 76.14.90- Të tjerë
 - po njëllon me atë që përdoret në gjenerimin e elektricitetit në transmetim dhe shpërndarje
- Shpjegimi 78.06 Artikuj të tjerë prej plumbi
 - kontenierë me veshje plumbi antirezatim, për transportin ose rezervimin e materialeve tepër radioaktive
- Shpjegimi 81.09 Zirkoni dhe artikujt e tij përfshirë skrapet dhe mbeturinat
- Shpjegimi 81.09.90- Të tjerë
 - Fishekët ose tubat për mbajtjen e elementeve me material nuklear
- Shpjegimi 82.07 Vegla të ndryshme për punë dore, me ose pa motor ose për makineri-pajisje (si p.sh. Për presim, stampim, shpim, taposje, puntim, filetim, shtehësim) përfshi vizim ose tërheqjen e metalit, shpimin e shkëmbit ose tokës etj.
- pajisje shpimesh, shkëmbi ose gropa në tokë:
- 8207.13- me pjesë punuese prej metalo-qeramike
- 8207.19- të tjera pjesë përbërëse
- Shpjegimi 83.07* Tuba fleksibël me bazë metalike me ose pa rakorderi
 - Për përdorim ekskluzivisht në pusët e naftës dhe gazit
- 84.01Reaktorët bërthamorë, materiali bërthamor (fishekë) jorezatues për reaktorët; makineri dhe aparatura për seperim izotopok
- 84.02 Kaldaja avulli, uji ose avujsh të tjerë (të ndryshëm nga ato të ngrohjes qendrore me ujë që janë në gjendje të prodhojnë avull të presionit të ulët); kaldaja uji të supernxehur
- 84.03 Kaldaja të ngrohjes qendrore, të ndryshme nga ato të treguara në nr. 84.02
- 84.04 Impiante ndihmëse që përdoren me kaldajat e treguara në nr. 84.02 ose 84.03 (si p.sh. Ekonomajzera, tejnxehesa, largues bloze, rikuperatorë gazrash); kondesatorë për avull ose njësi të ngjashme avujsh të tjerë
- 84.05 Gaz gjeneratorë ose ujë-gaz gjeneratorë, me ose pa pastruesit e tyre; gjeneratorët e gazit acetilen ose gjeneratorë të ngjashëm me proces uji, me ose pa pastruesit e tyre
- Shpjegimi 84.06 - Avull-turbinat e ujit, si dhe turbinat e avujve të tjerë të tjera turbina
- 8406.81- me fuqi mbi 40 MW
- 8406.823 - me fuqi deri 40 MW
- 8406.90 - pjesë turbinash
- Shpjegimi 84.08* Motora piston me djegie të brendshme me ndezie-komprimimi (diesel ose gjysmë diesel)
- Shpjegimi 8408.90 - Të tjerë motora
 - të rinj me fuqi mbi 50 kW
- Shpjegimi 84.09 Pjesë motorësh për përdorim vetëm ose kryesisht për motorët e treguar në nr. 84.07 ose 84.08.

8409.99- Të tjerë
84.10 Hidroturbinat, rrota uji dhe rregullatorët e tyre
84.11* Turbina avionic, turbo-propelere ose të tjera turbina gazi
84.13* Pompa lëngjesh, qofshin ose jo të pajisura me pajisje matëse; elevatorë lëngjesh.
Shpjegimi 84.14* Pompa ajri ose vakumi, kompresorë dhe ventilatorë ajri ose gazesh;
Pajisje ventiluese ose riciklike që përfshihen në trupin e ventilatorëve të pajisur ose jo me
filtra
ventilatorë ajri
Shpjegimi 8414.59- Të tjerë
-ventilatorë minierash ose të TEC-eve
8414.80 - Të tjerë
8414.90 - Pjesë ventilatorësh
84.16 Djegësit për furrat me lëndë djegëse të lëngët, të gaztë ose të ngurtë pluhur; hedhësit
mekanikë përfshi ato për skarat mekanike, shkarkuesit e hirave dhe pajisje të ngjashme me to
Shpjegimi 84.17 Furra laboratorike ose industriale joelektrike përfshi edhe gjeneratorët
Shpjegimi 8417.80- Të tjera furra
- përjashtimisht inceneratorët e mbetjeve, furrat laboratorike dhe ato furra që përdoren për
pjekjen e uraniumit
Shpjegimi 8417.90- Pjesë të furrave
-Përjashtimisht furrat për djegien e mbetjeve, ato laboratorike dhe të pjekjes së uraniumit
Shpjegimi 84.18* Frigoriferë ftohës, ngrirës dhe të tjera pajisje ftohëse ose ngrirëse
elektrike ose të tjerë; pompa nxehtësie të ndryshme nga makinat e kondicionimit të ajrit që
tregohen në nr. 84.15
pajisje të tjera ftohëse ose ngrirëse; pompa nxehtësie
8418.61 - pajisje të tipit me komprimim që i kanë kondensatorët e tyre me këmbyes
nxehtësie
8418.69 - të tjera pajisje
Shpjegimi 84.19* Makineri, impiante ose pajisje laboratorike, qofshin ose jo elektrikisht
të nxehtura për trajtime termike të materialeve sipas një procesi ku përfshihet një shkëmbim
temperature si nxehtja, gatimi, pjekja, distilimi, rektifikimi, sterilizimi, pasterizimi, avullimi, tharja,
përpunimi me avull, kondensimi ose ftohja freskuese dhe të tjera të ndryshme nga ato makineri e
pajisje të llojit që përdoren për qëllime shtëpiake; ngrohës uji të çastit ose rezervuarë, por jo
elektrikë.
- Pajisje këmbimi nxehtësie
- Makineritë për lëngështimin e ajrit ose gazeve të tjerë
- të tjera makineri, pajisje dhe impiante:
8419.89 - të tjerat
Shpjegimi 84.21* Centrifugat përfshirë tharësit centrifugalë; makineri filtrimi ose purifikimi
dhe aparatat për lëngje dhe gaze
Makineri dhe aparatat të filtrimit dhe purifikimit të lëngjeve:
- për filtrim ose purifikim të ujit
filtrues ose purifikues të gazeve:
- Të tjerat
Shpjegimi 84.25* Karukulla dhe cikrikë të ndryshëm nga organellot e skipeve; vinça dhe
gritësa; krikët
8425.20- Arganello e pusit minierës; vinça specialë për nëntokën
Shpjegimi 84.26* Direkë anijesh; vinça përfshirë ato me litar; ashensorë portativë
ngarkesash; vinça cjaq dhe automjete të pajisura me vinça
Shpjegimi 8426.20- Vinçat kullë
- për platformat detare dhe kalatat bregdetare
- të tjera makineri:
Shpjegimi 8426.91- të projektuara për t'u montuar në automjetet rrugore

- pajisjet ngritëse për riparimin dhe kompletimin e puseve
- Shpjegimi 84.29 Buldozerë vetëgërmues me helikë, me thikë këndore, nivelues, copëtues, rrafshues, lopatë mekanike, ekskavatorë, ngjeshës goditës, ngjeshës me rul.
- Lopata mekanike, ekskavatorë dhe lopatë
- Vetëshkarkuese
- Shpjegimi 8429.51- Vagon balloro-fundor
- vagonë specialë për përdorim nën tokë
- Shpjegimi 84.30 Të tjera makineri që përdoren për gërryerjen, nivelimin, copëtimin, hapjen, mbylljen, ngjeshjen ose shpimin e tokës ose minierave; ngulësa e shkulësa të pilonave; shtytësa, plugje, fryrësa të dëborës
- makineri shpimi ose preje të qymyrgurit:
- 8430.31 - vetëfrezuese
- 843039 - të tjera makineri të tjera merr shpim ose thithje
- Shpjegimi 8430.41- vetëfrezuese
- për zbulimin ose shfrytëzimin e depozitave të naftës dhe gazit
- Shpjegimi 8430.49- të tjerat
- për zbulimin ose shfrytëzimin e depozitave të naftës dhe gazit
- Shpjegimi 84.31 Pjesë makinerish të përshtatshme vetëm ose kryesisht për t'u përdorur në zërat e treguara nga numrat. 84.25 – 84.30 vetëm për makineritë e përfshira
- 84.71* Makineri të përpunimit automatik të të dhënave dhe pjesë si to, lexues magnetikë ose optikë, makina të transkriptimit të të dhënave nga e për mediat në formë të koduar ose makinat që përpunojnë të dhënat e tilla, jo gjithmonë të specifikuar ose të përfshira.
- Shpjegimi 84.74 Makineri për ndarjen, shoshitjen, veçimin, larjen, copëtimin, grimcimin, përzierjen e dherave, gurëve minerale të ndryshëm në gjendje të ngurtë, (përfshirë si pluhur ose pastë); makineri për aglomerimin, formimin e formave, ose zemrave prej mineralesh të ngurtë dhe lëndësh djegëse, pastave qeramike, çimentos pluhur, materialeve plastifikuese, ose të tjera produkte në gjendje pluhuri ose pastash që përdoren në fonderi për modelet prej rëre.
- 8474.10 - makineri të ndarjes, shoshitjes, veçimit, ose larjes së materialeve.
- 8474.20 - makineri thyerje-copëtimi
- Shpjegimi 8474.90- pjesë të makinerive
- pjesë prej gize ose çeliku të derdhur
- Shpjegimi 84.79* Makineri dhe pajisje mekanike që kanë funksione individuale, të specifikuar apo përfshirë diku gjatë në këtë kapitull.
- të tjera makineri dhe pajisje mekanike:
- Shpjegimi 8479.89- të tjera
- suportë hidraulike të lëvizshme për çatitë e minierave
- Shpjegimi 84.81 Valvula, rubineta, ventila dhe pajisje të ngjashme për tubacionet, kaldajat, rezervuarët, vaskat ose të tjera, ku përfshihen valvulat e reduktimit të presionit dhe valvulat e kontrollit termostatik.
- 8481.10 - valvulat e reduktimit të presionit
- valvulat për transmisionet pneumatike dhe hidraulike
- 8481.40 - valvulat e sigurimit dhe të shkarkimit
- të tjera pajisje
- 8481.90 - pjesë të valvolave
- Shpjegimi 84.83 Boshte transmisioni (përfshirë boshte dhe manivela) dhe boshte motorike; fole kushinetash rrokullisëse dhe të sheshta; rrota me dhëmbë dhe reduktorë; shnekë me sfera ose rula; kuti shpejtësie dhe reduktorë përfshirë konverterë me rrotullim; volante pulexha, përfshirë blloqet, xhunta me gunga e (llojit universale të boshteve).
- Shpjegimi 8483.40 - rrota dhe ingranazhe të ndryshme nga ato me dhëmbë, rrotat për zinxhirë dhe elemente të tjera transmisioni që paraqiten veçmas; vida me sfera ose rula; kuti shpejtësie dhe të tjerë ndërues shpejtësie, përfshirë konvertuesit me rrotullim
- elemente transmisionesh ekskluzivisht për përdorim në pompat thithëse me shtagë në industrinë e naftës dhe gazit

Shpjegimi 84.84* Guarnicion ose një bashkues i ngjashëm prej metali në kombinim me materiale fletë të tjera ose me dy ose më shumë shtresash metali; shtresa ose asortimente të tjera guarnicionesh dhe bashkime të ngjashme me përbërje të ndryshme të futura në qese, zarfe ose paketime të ngjashme; hermetizues mekanikë, guarnicione.

8484.10 - guarnicione dhe bashkime të ngjashme me fletë metalike të kombinuara me materiale të tjera ose prej dy ose më shumë shtresash metalike.

8484.20 - hermetizues guarnicione mekanike

85.01* Motora elektrikë dhe gjeneratorë elektrikë (përfshirë Gen-set).

85.02* Gjeneratorë tip Gent-set dhe konverterë rotativë

85.03* Pjesë të përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me makineritë që rreshtohen në zërat nr. 85.01 ose 85.02.

85.04* Transformatorë elektrikë, konverterë statikë (p.sh. Rektifikues-pastrues) dhe Induktorë

- transformatorë me lëngje dielektrike

- me kapacite shfrytëzimi të fuqisë jo më shumë se 650 kVA

- me kapacite shfrytëzimi të fuqisë mbi 650 kVA deri 10,000 Kva

- me kapacite shfrytëzimi të fuqisë mbi 10,000 kVA

- të tjerë transformatorë :

- me kapacite shfrytëzimi të fuqisë mbi 16 kVA

8504.33- me kapacite shfrytëzimi të fuqisë mbi 500 kVA

8504.34 - konvertues statikë

8504.40 - induktorë të tjerë

8504.90- pjesë për transformatorë

Shpjegimi 85.07* Akumulatorë elektrikë përfshirë seperatorë, qofshin ose jo drejtkëndorë (përfshirë at atë sheshte)

- përfshirë përdorimin për sektorët joenergjetikë

85.14 Furra elektrike industriale ose laboratorike (përfshirë ato induktive ose dielektrike); të tjera pajisje nxehëse industriale ose laboratorike me induksion ose dielektrike.

Shpjegimi 85.26* Aparatura radari, aparate radio-navigacioni dhe aparate radio-kontrolli në distancë

- Aparaturë radari

- të tjera:

8526.91 - Aparatura ndihmëse radio-navigacioni

85.31* Aparatura elektrike me sinjalizim me zë ose dritë (p.sh. zilet, sirenat, panelet tregues, alarme vjedhje, zjarri), të tjerë nga ato që përfshihen në zërat 85.12 ose 85.30.

Shpjegimi 85.32 Kondesatorë elektrikë, fiks, variabël ose të rregullueshëm (para-rregullim)

- kondesatorë fiks të projektuar për t'u përdorur në qarqet me frekuencë 50/60 Hz dhe që kanë kapacitet shfrytëzimi të fuqisë reaktive jo më pak se 0.5 kvar (kondesatorët e fuqisë).

85.35 Aparaturat elektrike për çkyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike ose për kryerjen e lidhjeve për ose me qarqet elektrike (p.sh. çelësa, siguresa, ndalues ndriçimi, limitatorë tensioni, rregullatorë valësh, çelësa prize, kuti kontakti për tensione mbi 1000 Volt).

85.36 Aparaturat elektrike për çkyçjen ose mbrojtjen e qarqeve elektrike ose për kryerjen e lidhjeve nga ose me qarqet elektrike (p.sh. çelësat, reletë, siguresat, rregullatorët e valës, prizat mashkull-femër, portollampat, kutitë shpërndarëse për tensione që nuk kalojnë 1000 Volt).

Shpjegimi 8536.10- Siguresa -- mbi 63 amper

Shpjegimi 8536.20- Shkëputës automatik qarqesh -- mbi 63 amper

Shpjegimi 8536.30- Aparatura të tjera për mbrojtjen e qarqeve elektrike -- mbi 16 amper

- Relete:

8536.41- për tensione nën 60 Volt

8536.49- të tjera aparatura

85.37 Shpjegimi 8536.50- të tjerë çelësa -- për tensione mbi 60 Volt

Stenda, panele, konsola, tryeza, kabina dhe të tjera baza që janë të pajisura me dy ose më shumë aparatura që rreshtohen në nr. 85.35 ose 85.36, për kontrollin ose për shpërndarjen e elektricitetit, përfshirë ato aparatura ose instrumente që përmbahen në kapitullin 90 dhe aparatrave kontroll numerik që janë të ndryshme nga aparaturat e çkyçjes të dhëna në nr. 85.17.

85.38 Pjesë të përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose si rregull me aparaturat e treguara në nr. 85.35, 85.36 ose 85.37.

Shpjegimi 85.41 Dioda, transistorë dhe gjysmëpërçues të ngjashëm me to; pajisje gjysmëpërçuese foto sensitive, duke përfshirë qeliza fotovoltaike qofshin ose jo të komponuara në module ose të vendosura në panela; dioda me emetim drite (llampa); kristale piezo-elektrike të montuar.

Shpjegimi 8541.40- pajisje gjysmëpërçuese fotosensitive, përfshirë qeliza fotovoltaike janë ose jo të komponuara në module ose të vendosura në panele; llampa-dioda emetuese drite.

- pajisje gjysmëpërçuese fotosensitive, përfshirë qeliza fotovoltaike qofshin ose jo të komponuara në module ose të vendosura në panele.

Shpjegimi 85.44 Tela të izoluar (përfshirë të emaluar ose anoduar), kabëll (përfshirë ata koaksiale) dhe të tjerë përçues elektrikë të izoluar qofshin ose jo të pajisur me bashkues ; kabëll fibrash optike të prodhuara individualisht në kallëpe, qofshin ose jo të komponuara me përçues elektrikë ose të pajisur me bashkuese.

85 44.60 - Të tjerë përçues (konduktorë) elektrikë për tensione mbi 1000 Volt

8544.70 - Kabëll me fibra optike

Shpjegimi 85.45 Elektroda karboni, brusha karboni, llampa karboni, bateri karboni dhe artikuj të tjerë prej grafiti ose karbonike me ose pa metal të çdo lloji që përdoret për qëllime elektrike.

8545.20 - Brusha (karboncina)

85.46 Izolatorë elektrikë prej çdo materiali

85.47 Armatura izolacioni të makinave elektrike, pajisje ose nyje që i kanë armaturat krejtësisht prej metali izolues me përjashtim të ndonjë komponenti të vogël prej metali (p.sh. prizat) që futen gjatë formimit vetëm për qëllimet e montimit, të tjerë nga izolatorët e treguar në nr. 85.46; tuba bashkues dhe lidhës prej metali si bazë të veshur me një shtresë materiali izolues.

Shpjegimi 87.04 Motor automjetesh për transportin e mallrave.

të tjerë motorë me piston me djegie të brendshme me ndezje komprimim (diesel ose gjysmë diesel) :

Shpjegimi 8704.21- me peshëngritje nën 5 ton (g.v.w)

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive

Shpjegimi 8704.22- me peshëngritje mbi 5 ton, por jo më shumë se 20 t

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive

Shpjegimi 8704.23- me peshëngritje mbi 20 ton

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive të tjerë motorë me djegie të brendshme me piston që ndizen me shkëndijë elektrike.

Shpjegimi 8704.31- me peshëngritje nën 5 ton

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive

Shpjegimi 8704.32- me peshëngritje mbi 5 ton

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive

Shpjegimi 87.05 Motorë automjetesh për qëllime speciale të tjerë nga ato që kryesisht janë të projektuar për transportimin e personave ose mallrave (p.sh. kamionë, autovinça, autozjarrfikëse, autobetonierë, autoplehrash, autospërkatëse, autosalla lëvizëse, njësi radiologjike të lëvizshme).

8705.20 - kulla shpimi të lëvizshme

Shpjegimi 87.90 Tërheqës pune të vetë lëvizës të papajisur me pajisje ngritëse ose tërheqëse, në tipet që përdoren në fabrika, magazina, porte ose aeroporte për transportim mallrash në distanca të shkurtra; traktorë të tipeve që përdoren në sheshet e stacioneve të trenit; pjesë të automjeteve të sipërpërmendura.

- Automjete:

Shpjegimi 8709.11- Elektrike

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive.

Shpjegimi 8709.19- të tjerë

- të projektuar apostafat për transportimin e materialeve tepër radioaktive.

Shpjegimi 89.05 Anije të lehta, anije zjarrshuese, dragëlënduese, vinçlundrues dhe të tjera anije që kanë përdorime ndihmëse të funksionimit, doke lundruese ;platforma lundruese ose të zhytura për shpime ose prodhim .

8905.20 - platforma lundruese ose të zhytura për shpime ose prodhim

Shpjegimi 90.15 Pajisje dhe instrumente për mbikëqyrje (përfshirë survejimet foto grametrike) në hidrografi, oqeanografi, hidrologji meteorologji, gjeofizikë, por duke përjashtuar busullat, telemetrat.

Shpjegimi 9015.80 - të tjera instrumente dhe pajisje

- vetëm instrumente gjeografike

- pjesë dhe aksesore

Shpjegimi 90.26* Instrumentet dhe aparatura për matjen ose kontrollin e prurjes, nivelit, presionit ose variablave të tjerë të gazeve ose lëngjeve (p.sh. Kalimmatës, nivelmatës, manometra, nxehtësimatës), përjashton instrumentet dhe aparaturat që janë treguar në nr. 90.14, 90.15, 90.28 ose 90.32.

- me përjashtim të atyre që përdoren në industrinë e shpërndarjes së ujit.

90.27 Instrumente dhe aparate për analiza fizike ose kimike (p.sh. Poliametra, refraktometra, spektrometra, gaz ose tym analizatorë); instrumente dhe aparatura për matjen ose kontrollin e viskozitetit, porozitetit, zgjerimin, tensionin sipërfaqësor ose të ngjashëm me to; instrumente dhe aparatura për matjen ose kontrollin e sasisë së nxehtësisë, tingullit ose ndriçimit (përfshirë ekspzimatësit); mikrofonat, matësit (kontatorët) e furnizimit me gaz, lëngje ose elektricitet, duke përfshirë dhe matësit kalibrues të tyre.

Shpjegimi 90.29* Numërorë rrotullues, numërues prodhimi, taksimetra, hapamatës dhe të ngjashëm me të; tregues shpejtësie dhe tahometra të tjerë që nuk rreshtohen në nr. 90.14 ose 90.15; stroboskope.

Shpjegimi 9029.10- Numërorë rrotullues, numërues prodhimi, taksimetra, hapamatës dhe të ngjashëm me të

- Numërorë prodhues

Shpjegimi 9029.90- Pjesë dhe aksesore

- të numërorëve prodhues

Shpjegimi 90.30* Oshiloskope, analizues spektrale dhe të tjerë instrumente dhe aparatura për matjen ose kontrollin sasior të elektricitetit përjashtoj rreshtimet në nr. 90.28; instrumente ose aparatura për matjen ose zbulimin e rrezatimit me reze alfa, beta, gama X, rrezatimit kozmik ose të tjerëve jonizues.

Shpjegimi 9030.10- instrumente dhe aparatura për matjen ose zbulimin e rrezatimeve jonizues

- për përdorim në sektorin energjetik

- të tjera instrumente dhe aparatura për matjen ose kontrollin e tensionit, rrymës, rezistencës ose fuqisë pa kompletin e regjistruarit:

9030.31- multimetrat

9030.39- të tjerë

- instrumente dhe aparate të tjera

Shpjegimi 9030.83- të tjerë me kompletin regjistruar

- për përdorim në sektorin energjetik

Shpjegimi 9030.89- të tjerë

- për përdorim në sektorin energjetik

Shpjegimi 9030.90- pjesë dhe aksesore

- për përdorim në sektorin energjetik

*90.32 Instrumente dhe aparatura me kontroll dhe drejtim automatik.

4. ANEKS EQ II

Lista e pajisjeve që lidhen me energjinë

(Në pajtueshmëri me nenin 1(4bis))

14. ANEKS BR

LISTA E PALËVE KONTRAKTUESE TË CILËT NUK DO TË RRISIN ASNJË DOGANË OSE SHPENZIME TË TJERA MBI NIVELIN QË KANË REZULTUAR NGA ANGAZHIMET OSE KLAUZOLAT E APLIKUESHME SIPAS MARRËVESHJES SË OBT (WTO)

(në përputhje me nenin 29 (7))

15. ANEKS BRQ

LISTA E PALËVE KONTRAKTUESE TË CILËT NUK DO TË RRISIN ASNJË DOGANË OSE SHPENZIME TË TJERA MBI NIVELIN QË KANË REZULTUAR NGA ANGAZHIMET OSE KLAUZOLAT E APLIKUESHME SIPAS MARRËVESHJES SË OBT (WTO)

(në përputhje me nenin 29 (7))

Neni 6

Zbatimi i dispozitave

1) Çdo nënshkrues i cili aplikon dispozitat e Traktatit të Kartës së Energjisë në përputhje me nenin 45(1) dhe çdo Palë Kontraktuese bie dakord ta aplikojë këtë Amendament provisanly duke mbajtur pezull hyrjen e tij në fuqi për këto Palë Kontraktuese me qëllimin e që zbatimi dispozitave nuk është i papajtueshëm me kushtetutën, ligjet dhe rregullat.

2)(a) edhe paragrafi (1)

i)çdo nënshkrues i cili aplikon dispozitat e traktatit të Kartës së Energjisë ose Palët Kontraktuese mund të shpërndajnë në depozitën brenda 90 ditëve nga data e miratimit të këtij amendamenti nga Konferenca e Kartës një deklaratë që nuk është në gjendje të pranojë zbatimin e dispozitave të këtij amendamenti.

ii)çdo nënshkrues që nuk aplikon dispozitat e Traktatit të Kartës së Energjisë në përputhje me nenin 45(2) mund të depozitojnë jo më vonë se data në të cilën ato kthehen në Palë Kontraktuese ose fillojnë të aplikojnë dispozitat e Traktatit me një deklaratë në të cilën nuk janë në gjendje të pranojnë zbatimin e këtij amendamenti.

Obligimi, detyrimi që përmbahet në paragrafin (1) nuk do të aplikojë tek një nënshkrues apo Palë Kontraktuese bërjen e deklaratave të tilla. Ndonjë nënshkrues ose Palë Kontraktuese mundet në çdo kohë ta tërheqë deklaratën me një shënim të shkruar në depozitim.

b) Asnjë nënshkrues ose Palë Kontraktuese që bëjnë një deklaratë në përputhje me një nënparagraf (a) asnjë investitor i këtij nënshkruesi apo Palë Kontraktuese mund të deklarojë përfitimet e zbatimit të dispozitave nën paragrafin (1).

3) Çdo nënshkrues ose Palë Kontraktuese mund të përfundojë zbatimin e këtij amendamenti nëpërmjet një njoftimi me shkrim te Depozituesi me qëllimin jo për ta ratifikuar, pranuar ose aprovuar këtë amendament. Përfundimi i këtij zbatimi për ndonjë nënshkrues ose Palë Kontraktuese do të ketë efekt mbi skadimin e 60 ditëve nga data në të cilën Depozita ka marrë shënimin e shkruar nga Pala Kontraktuese ose nënshkruesi. Çdo nënshkrues i cili përfundon zbatimin e dispozitave të Traktatit të Kartës së Energjisë në përputhje me nenin 45(3)(a) do të konsiderohet njëloj sikur dhe zbatimi dispozitave të këtij amendamenti të ketë përfunduar me të njëjtën datë të efektit.

Neni 7

Statusi i vendimeve

Vendimet e miratuara në lidhje me miratimin e këtij amendamenti janë pjesë integrale e Traktatit të Kartës së Energjisë.

VENDIMET NË LIDHJE ME MIRATIMIN E AMENDAMENTIT TË DISPOZITAVE TË TREGTISË TË TRAKTATIT TË KARTËS SË ENERGIJË

(ANEKS 2 I AKTIT FINAL TË KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE DHE VENDIMI I KONFERENCËS SË KARTËS SË ENERGIJË)

1. Një nënshkrues i cili nuk aplikon amendamentin e miratuar më datë 24 prill 1998 dispozitive, mundet në kohë të ndërmarrë veprimin për të aplikuar këtë amendament, ose në baza definitive ose të përkohshme, njofton Sekretariatit me shkrim deri sa të listohet në aneksin BR dhe BRQ, ai do të aplikojë amendamentin sikur të gjithë paragrafët e materialeve të energjisë dhe produktet dhe që pajisjet që lidhen me energjinë vazhdojnë të listohen në anekset EM I dhe EQ1.

Amendamenti do të aplikohet në përputhje me këtë nënshkrues të tillë.

Çdo nënshkrues mundet në çdo kohë të tërheqë shënimin (njoftimin) që i referohet për sa më sipër shkruar Sekretariatit.

2. Dispozita përfundimtare e amendamentit do të bazohet në pjesën e VIII, në veçanti neni 42 i Traktatit të Kartës së Energjisë aq sa të zgjasë.

QENDRIMI I KRYETARIT NË MIRATIMIN E SEKSIONIT NË 24 PRILL 1998

“Në çështjen e listimit të vendeve të aneksit BR dhe BRQ, unë konkludoj që të gjitha delegacionet janë në dijeni të pozitive të qëndrueshme të këtyre delegacioneve siç janë Australia, Hungaria dhe Japonia vazhdimisht në mënyrë të përsëritur kanë nënvizuar që ata mbështesin angazhimin për tarifën detyruese ligjore, provuan angazhimet e tyre nën Traktatin e Kartës së Energjisë reflekton angazhimin e tyre në OBT (WTO). Kjo gjithashtu reflekton pozicionin e delegacioneve të tjera, dhe është një pranim i përgjithshëm midis delegacioneve që ato do të japin konsideratë pozitive për këtë pozicion në kohën kur vendimi mbi për tarifën detyruese ligjore është marrë.”

KONKLUZIONI I KRYETARIT MBI ZBATIMIN E RREGULLAVE QË RRJEDHIN NGA TREGTIA, NË KONFERENCËN E KARTËS SË ENERGIJË NË 24 PRILL 1998

Kryetari arriti në përfundimin lidhur me zbatimin e ardhshëm të rregullave që rrjedhin nga tregtia që ishte një konsensus midis delegacioneve që Sekretariati ishte ftuar të zhvillonte elementet për një sistem implementimi bazuar në regjimin e amendamentit të tregtisë. Në veçanti, ky amendamenti i tregtisë parashikon kërkesat për njoftim dhe procedura, përfshirë atë në përputhje me amendamentin 2 të mirëkuptimit, ato do të ndjekin praktikën e WTO, duke siguruar që dublikimi i njoftimeve me WTO nuk do të ndodhë. Ka ekzistuar për më shumë një konsensus (mirëkuptim) që në zhvillimin e rregullave të mosmarrëveshjeve dhe procedurave të rregullave të WTO dhe praktikave që do të ndiqen.

Përfundimisht, kurdo të jetë e nevojshme për të mirëmbajtur parimet për një implementim të harmonizueshëm të rregullave që rrjedhin nga tregtia bazuar në praktikën e ndjekura për rregullat e OBT (WTO), rregullat e duhura të procedurave do të përfshijnë dhe elementet e nevojshme për të arritur qëllimin.

DEKRET

Nr. 4945, datë 27.6.2006

PER LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Nëmbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5. 8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. Rajmonda Osman Samuels (Hoxha) | 21. Hershor Shaqir Cara |
| 2. Kristo Reis Malaj | 22. Mirnoza Syrja Jaho (Çami) |
| 3. Luljana Mehmet Sarigiannidis (Bali) | 23. David Agron Jaho |
| 4. Kristi Fatmir Bujku | 24. Eliot Shpëtim Hima |
| 5. Valentina Ferat Steininger (Mataj) | 25. Edlira Skënder Graf (Kamberi) |
| 6. Miran Rexhep Shehi | 26. Pal Marash Delia |
| 7. Ilirjana Enver Shehi (Duka) | 27. Veronika Mane Delia (Alikaj) |
| 8. Elis Skënder Qelesi | 28. Besnik Sherif Çekrezi |
| 9. Dashomir Ibrahim Tanuzi | 29. Mirela Halit Hysa (Tafa) |
| 10. Stiven Dashomir Tanuzi | 30. Ana Alfred Shtëpani |
| 11. Fatmir Ali Ago | 31. Soela Qemal Gebhardt (Prizrendi) |
| 12. Alma Nuro Händel (Hasanaj) | 32. Eduart Xhevit Skenderi |
| 13. Andi Qerim Bullari | 33. Antoneta Rrok Kola |
| 14. Shpresa Naim Rumpf (Shameti) | 34. Besa Ismail Denk (Rexha) |
| 15. Viktor Kolë Ndreka | 35. Bizena Eqber Wunderlich (Qylafi) |
| 16. Pireta Lefter Fiedler (Çipa) | 36. Ornela Ashim Keibl (Ibrahimi) |
| 17. Isuf Nazmi Biba | 37. Niko Brahim Dino |
| 18. Ritjana Jani Kolezi | 38. Mariola Agim Ismaili |
| 19. Albana Ahmet Sopa (Balliu) | 39. Nertila Qamil Dumke (Hoxha) |
| 20. Merita Risa Sulollari (Alilaj) | 40. Liljana Rudi Heinecke (Spahija) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4948, datë 29.6.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Arben Cici, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4949, datë 29.6.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Qiriako Qirko lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë Hollandeze.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4950, datë 29.6.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Edmond Trako, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Argjentinës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) | 1500 |
| 2. | PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) | 600 |
| 3. | PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... | 1500 |
| 4. | PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) | 1500 |
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... | 1500 |
| 2. | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... | 2000 |

BOTIME TË REJA

- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT | 500 |
| 2. | KODI DOGANOR | 1000 |
| 3. | KODI DETAR | 1000 |

Hyri në shtyp më 4.7.2006
 Doli nga shtypi më 5.7.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
 Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë